



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 26, datë 04.03.2019

**PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË
FONDIT TË PENSIONIT DHE SIPËRMARRJES SË INVESTIMEVE KOLEKTIVE
“CREDINS INVEST ” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 22 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar” dhe të neneve 12 dhe 14 të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjen e investimeve kolektive”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes të Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e ndryshimit të nenit 5 të statutit të shoqërisë administruese të fondit të pensionit dhe sipërmarrjes së investimeve kolektive “Credins Invest” sh.a, si më poshtë vijon:**

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

- 5.1 Kapitali i nënshkruar dhe i paguar tërësisht i shoqërisë është 95,822,394.00 lekë i përbërë prej 233,713.17 aksione me vlerë nominale 410 (katërqinddhjetë) lekë secili.
- 5.2 Kapitali aksionar i shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para (likuide) dhe zotërohet nga aksionarët e shoqërisë si më poshtë:
 - a) Pjesëmarrja aksionare e “Bankës Credins” sh.a. është në nivelin 76.00 %, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 72,825,019.00 si dhe me 177,622.00 aksione.

- b) Pjesëmarrja aksionare e “SiCRED” sh.a., është në nivelin 12.00 %, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 11,498,687.00 si dhe me 28,045.58 aksione.
- c) Pjesëmarrja aksionare e Znj. Estela Koçi, është në nivelin 5.00 %, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 4,791,120.00 si dhe me 11,685.66 aksione.
- d) Pjesëmarrja aksionare e Z. Egi Santo, është në nivelin 3.5 %, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 3,353,784.00 si dhe me 8,179.96 aksione.
- e) Pjesëmarrja aksionare e Z. Genc Koxhaj, është në nivelin 3.5 %, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 3,353,784.00 si dhe me 8,179.96 aksione.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI